



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 887/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Ymer Hoxha dhe Nenad Lazić anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Isuf Musliu kandidat i pavarur për kryetar të komunës së Shtimes, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 18.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Isuf Musliu kandidat i pavarur për kryetar të komunës të Shtimes.

Arsyetim

Me datën 15.11.2013, Isuf Musliu kandidat i pavarur për kryetar të komunës të Shtimes, ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën ankesë pretendohet se në zgjedhjet e 03 Nëntorit në komunën e Shtimes ka pasur parregullsi të llojeve të ndryshme, parashtruesi i ankesës ka cekur se në të gjitha vendvotimet, nuk i janë caktuar as komisioner as vëzhgues nga ana e KQZ-së, votuesve nuk ju është lejuar fotografimi i votës, ai pretendon se është votuar nga 5200 votues nga të gjitha Qendrat e Votimit (QV), dhe se pretendon se i posedon të gjitha nënshkrimet e votuesve të cilët e kanë votuar. Parashtruesi i ankese shpall veten fitues në bazë të dëshmive të votuesve dhe kërkon që të ndëshkohen para drejtësisë të gjithë manipuluesit e votave. Lidhur me këto manipulime ka lajmëruar policin e Kosovës dhe prokurorin e shtetit.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Me nenin 118.4 LZP-së, parashihet se: *“Mund të apelojnë vendimet e PZAP-it, sikurse PZAP-i mund të rishikoj cilindo nga vendimet e marra pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar”*.

PZAP-i konstatoi se pretendimet e Isuf Musliut kandidat i pavarur për kryetar të komunës të Shtimes nuk qëndrojnë ngase në shkesat e lëndës nuk ka bashkangjitur asnjë provë bindëse që mund të vërtetoj parregullsitë e pretenduara. PZAP-i, konstatoi se një pretendim i tillë është i pa argumentuar në prova relevante , andaj në kuptim të nenin 3.6 pika c) të Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it si dhe nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 887/2013 më datën 18.11.2013.

**Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha**



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.